



Tirane me 15.07.2005

### AKT EKSPERTIMI

#### MBI ZMADHIMIN E KAPITALIT TE SHOQERISE "SOFIGAZ" SHPK

Me Vendimin nr 7 date 20.05.2005 te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "SOFIGAZ" shpk dhe me Vendim Gjykatë nr 15470/7 date 14.07.2005 është bere caktimi im si eksperte per zmadhimin e kapitalit te kesaj shoqerie.

Shoqeria "SOFIGAZ" shpk është krijuar me vendim gjykatë Nr 15470 date 19.07.1996, me object ne fushen e prodhimit dhe te tregtise. Kjo shoqeri zoterohet nga ortakët "Multigas Est" srl dhe Ardian Strazimiri me pjesmarrje ne kapitalin themeltar te shoqerise proporcionalisht ne masen 90 % me 10 % per seicilin ortakë.

Qe nga momenti i krijimit te saj shoqeria ka kryer aktivitet prodhues dhe tregtar dhe ka permbushur detyrimet e veta ligjore ne mbeshtetje me Ligjet "Per shoqerite tregtare", "Per Kontabilitetin" Per Sistemin Fiskal ne Shqiperi" e te tjera ligje qe operojne ne fushen e biznesit. Keto permbushje detyrimesh ligjore gjejne shprehjen e tyre ligjore ne Bilancet kontabel vjetore te depozituara prane organeve kopetente.

Shoqeria ne aktivitetin e saj vec Kapitalit themeltar prej 20.200.000 leke ka gezuar ne zhvillimin e biznesit edhe fitimet e realizuara , kontributin e ortakeve , si dhe Huate.

Me Vendimin nr 7 date 20.05.2005 te asamblese se ortakeve dhe me Vendim gjykatë nr 15470/7 date 14.07.2005, shoqeria vendos qe:


- **Te zmadhoje Kapitalin themeltar te shoqerise, kapital ky i materializuar ne natyre.**

Burimi i zmadhimit te ketij kapitali do te jete:

Bashkimi i Fitimeve neto (pasi jane zbritur te gjitha detyrimet ligjore ndaj shtetit) te realizuar gjate zhvillimit te aktivitetit, dhe konkretisht:

Gjate gjithë aktivitetit jane realizuar fitime neto (pasi jane zhveshur nga Tatim Fitimi ne vleren 31.300.741 leke.





Shprehja materiale e ketij fitimi verehet ne Aktivet e qendrueshme te trupezuara , te cilat ne 31.12.2004 kapin vleren neto kontabel prej 127.832.068 leke, si dhe ne vleren e materialeve gjendje ne daten 31.12.2004 qe po ashtu kapin nje vlere kontabel prej 36.958.655 leke.

Bilanci Kontabel i kesaj date i eshte bashkangjitur ketij akti ( si ne formatin e dates 31.12.2004 dhe ne formen mbas zmadhimit te Kapitalit).

Fitim ky , te cilin shoqeria ka vendosur ta ndaj si me poshte:

- Rritje e Rezerves ligjore per 1.500.741 leke.
- Zmadhim i Kapitalit te Shoqerise prej 29.800.000 leke.

Ne keto kushte :

- **Kapitali themeltar do te shtohet me 29.800.000 leke , duke shkuar ne kuoten e 50.000.000 leke.**

Edhe ne keto kushte, ruhet nje barazi proporcionale e plote ndermjet te dy ortakeve ne te Drejtat e tyre per cdo pjese te Kapitalit te Shoqerise, ne masen 90% per "Multigas Est" srl dhe 10% per Ardian Strazimiri.

Ne gjithë proceduren e krijimit te fitimit, shperndarjes me vendim ortakerie, kontabilizimit dhe zbardhjes ne Bilancet Kontabel ,vit mbas viti, te kuotes per tu bashkuar me Kapitalin themeltar dhe me Rezervat, , shpreh besueshmerine Time, te krijuar mbas nje analize te mirfillte te situates financiare te krijuar.

## KONKLUZIONI

Shperndarja e fitimit te realizuar nga aktiviteti i shoqerise deri ne 31.12.2004, , pasi i jane zhveshur detyrimet tatimore, si tatim fitimi dhe tatim mbi dividendet per pjesen e shperndare ndermjet ortakeve, ne perputhje me Ligjin "Per Tatim Fitimin" dhe Ligjin "Per Tatimin mbi te ardhurat" , si dhe pjesmarrja e kapitalit themeltar si kontribut ne natyre, ne zoterim te te dy ortakeve,do te zbulojne ne Bilancin Kontabel te vitit 2005 vlerat:

- Kapitali themeltar 50.000.000 leke
- Rezerva Ligjore 1.833.734 leke

**Opinionimi** im ne lidhje me kete zmadhim kapitali :

Eshte zbatuar Ligji hap pas hapi, dhe keto shifra shprehin realitetin e rritjes se Kapitalit themeltar, i cili qe nga ky moment do te kete vleren 50.000.000 leke e shperndare per:





- "MULTIGAS EST" SRL 90 % ose 45.000.000 leke, dhe
- Ardian STRAZIMIRI 10 % ose 5.000.000 leke.

*Ju faleminderit.*

EKSPERT KONTABEL / AUTORIZUR

*Vjollca* **DERVISHI**

EKSPERTE KONTABEL  
VJOLLCA DERVISHI  
NR. 056  
ALBANIA

